



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 31 datë 3.6.2021

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE
ME QIRA PËR KOMUNITETIN ROM”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 3.6.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; nenit 30 pika 2 e ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr. 522, datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom si më poshtë :
 - Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe $30 \text{ m}^2 = 1,900 \text{ Lekë/Muaj}$.
 - Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe $40 \text{ m}^2 = 2,500 \text{ Lekë/Muaj}$.Bashkëlidhur, shtojca A.
2. Niveli i qirasë është i vlefshëm deri me 31.01.2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R

Brisela KADIJA

Me autorizim

ZV. K R Y E T A R


Arvit OSJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 7.6.2021

Shtojca A: Metodika e Llogaritje së Masës së Qirasë Për Banesat Sociale me Qira:

Përcaktimi i qirasë mujore për Banesat Rome sipas pikës 5 dhe 8 të VKM Nr. 522, Datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira” është si më poshtë:

Kostoja totale për Apartamentin 1+1 sipas situacionit përfundimtar të datës 30.10.2020 është :

Kosto Totale = 760,440 Lekë

Sipërfaqja totale e **apartamentit 1+1** është 30 m², ndërsa sipërfaqja që do përdoren për strehim social është 30 m² dhe për të llogaritur koston e sipërfaqes së banimit duhet të përcaktojmë koeficientin që zë kjo sipërfaqe ndaj totalit(30 m² / 30 m² = 100 %).

K_{banimit} = 760,440 Lekë

QV total = 760,440 x 3% = 22,813 Lekë

QM total = 22,813 Lekë / 12 = 1,900 Lekë/Muaj

S_{banimit} = 30 m²

S_I = 30 m² P_A = 30/30 = 1 = 100 %

Q_m = 1 x 1,900 = 1,900 Lekë/Muaj

Kostoja totale për **apartamentin 2+1** sipas situacionit përfundimtar të datës 30.10.2020 është :

Kosto Totale = 1,000,200 Lekë

Sipërfaqja totale e apartamentit 2+1 është 40 m², ndërsa sipërfaqja që do përdoren për strehim social është 40 m² dhe për të llogaritur koston e sipërfaqes së banimit duhet të përcaktojmë koeficientin që zë kjo sipërfaqe ndaj totalit(40 m² / 40 m² = 100 %).

K_{banimit} = 1,000,200 Lekë

QV total = 1,000,200 x 3% = 30,000 Lekë

QM total = 30,000 Lekë / 12 = 2,500 Lekë/Muaj

S_{banimit} = 40 m²

$$S_1 = 40 \text{ m}^2 \quad P_A = 40/40 = 1 = 100 \%$$

$$Q_m = 1 \times 2,500 = 2,500 \text{ Lekë/Muaj}$$

Shkurtime:

K. Total = Vlera fillestare e objektit, minus shkallën e amortizimit deri në 2019 plus vlerën e rikonstruksionit plus tarifën e regjistrimit të pasurisë.

K_{banesa} = Kostoja e sipërfaqes së banimit.

QV_{total} = Qiraja vjetore për të gjithë objektin. (**K x 3%**)

QM_{total} = Qiraja mujore për të gjithë objektin. (**QV_{total} / 12**)

S = Sipërfaqja e përgjithshme e banimit.

S_A = Sipërfaqja e një apartamentit tip.

P = Përqindja që zë sipërfaqja e apartamentit ndaj totalit. (**S_A / S**)

QM_A = Qiraja mujore e apartamentit tip.

